



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, datë 07.06.2016

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “SHITESË ANËSORE**  
**OBJEKTI 2 KATE, ME FUNKSION MAGAZINIM DHE ZYRA, SI DHE**  
**RIKONSTRUKSION I GODINËS EKZISTUESE”, NË ZYRAT QENDRORE TË “ALEAT”**  
**SH.P.K”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1097, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt kërkues “Aleat” sh.p.k”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë anësore objekti 2 kate, me funksion magazinim dhe zyra, si dhe rikonstruksion i godinës ekzistuese”, në zyrat qendrore të “Aleat” sh.p.k”, me vendndodhje: “Ish-Tipografia Ushtarake”, Bashkia Tiranë, me subjekt kërkues “Aleat” sh.p.k”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

